



## URDHËR

Nr. 475, datë 20.7.2023

**PËR MIRATIMIN E FORMËS SË  
DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT  
TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR  
SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar dhe të nenit 28, pika 4 të ligjit nr 8/2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror",

## URDHËROJ

1. Miratimin e formës së dokumentit të identifikimit të përbaruesit gjyqësor shtetëror, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit dhe përbaruesit gjyqësorë shtetërorë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.



Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË  
Ulsi Manja

## SHTOJCË NR. 1

**FORMA E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR  
SHTETËROR**

Dokumenti i identifikimit të përbaruesit gjyqësor shtetëror ka formë drejtkëndëshe, me përmasa 8.5 cm x 5.5 cm dhe është pronë e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror. Me sfond të bardhë, logon e drejtësisë në sfond dhe me shkronja të zeza. Fotografia e përbaruesit gjyqësor shtetëror ka përmasa 3cm x 2 cm.

 <p>MINISTRIA E DREJTËSISË SHËRBI MI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PËRMBARIMIT</p> 
<p>Emër Mbiemër _____ Përbarues Gjyqësor Shtetëror _____ Zyra Përbarimore _____</p>

- Shërbimi Përbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbim Përbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe në Shërbim Përbarimor Gjyqësor Privat.
- Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përbaruesit gjyqësorë në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë kërkohet ndihma e tyre.
- Ky dokument përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyres ose për shkak të saj.

DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PËRMBARIMIT  
Drejtore i Përgjithshëm

(Emër Mbiemër) \_\_\_\_\_